

## **VENDIM**

**Prot/Nr 2, DATE 11.02.2008**

### **PER**

## **VENDOSJEN E PARALAJMERIMEVE TE DETYRUARA SHENDETSORE DHE INFORMACIONEVE TE TJERA MBI PAKETAT E PRODUKTEVE TE DUHANIT**

Komiteti Ndersektorial Per Mbrojtjen e Shendetit nga Produktet e duhanit, ne mbledhjen e tij ,te datës 11.02.2008 me pjesmarjen e :

Z. Nard Ndoka, Ministër i Shëndetësisë, Kryetar

Z. Florian Mima, Zëvendësministër i Financave, anëtar

Z. Ferdinand Pone, Zëvendësministër i brendshëm, anëtar

Z. Halit Shamata, Zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës, anëtar

Z. Zana Turku, Zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Z. Alban Ylli, Drejtor i Institutit të Shëndetit Publik

Komiteti Ndersektorial Per Mbrojtjen e Shendetit nga Produktet e duhanit (KNMSHPD)pasi morri ne shqyrtim vendosjen e paralajmerimeve shendetesore dhe informacioneve te tjera si dhe mbas konsultimesh edhe me grupet e interesit mbi paketat e produkteve te duhanit ne mbeshtetje dhe ne zbatim te neneve 4 dhe 18 te ligjit nr.9636,date 6.11.2006, "Per Mbrojtjen e Shendetit nga Produktet e Duhanit" si dhe pikave 2, 4 dhe 8 te vendimit te Keshillit te Ministrave,"Per organizimin,funksionimin,perberjen dhe percaktimin e mases se shperblimit te Komitetit Ndersektorial, Per Mbrojtjen e Shendetit nga Produktet e duhanit",

### **VENDOSI:**

1. Te miratoje formen dhe tekstin e paralajmerimeve te detyrueshme shendetesore ne produktet e duhanit :

Ne cdo njesi pakete apo paketim te produkteve te duhanit duhet te figurojne mesazhe paralajmeruese shendetesore per demet qe shkakton ne shendet perdorimi i produkteve te duhanit. Keto mesazhe duhet te jene te shkruara qarte ,dukshem dhe lexueshem ne gjuhen shqipe.

Keto mesazhe duhet te zene 50 perqind te faqes kryesore te shfaqur dhe 50 perqind te faqjes tjeter me te dukshme pas faqes kryesore te shfaqur te paketes apo paketimit te produktit te duhanit.

2. Cdo pakete njesi e produkteve te duhanit, me perjashtim te produkteve te duhanit per perdorim oral dhe te produkteve te tjera te duhanit pa djegje, do te permbajne te vendosura mbi to ,dy lloje paralajmerimesh te pergjithshme per demet ne shendet te duhanit ,perkatesisht:

- Paralajmerime te pergjithshme me tekstin:

- a) “Pirja e duhanit vret/Pirja e duhanit mund te vrase”.
- b) “Pirja e duhanit ju demton ju dhe te tjeret rreth jush”

Paralajmerimet e pergjithshme, si me siper, do te rrotullohen ne menyre te tille qe te sigurohet shfaqja e tyre e rregullt

Paralajmerimet e pergjithshme ,do te shtypen mbi faqen kryesore me te dukshme te paketes njesi dhe ne nje paketim te jashtem (steke), me perjashtim te mbeshtjellesve transparente te perdoruara ne shitjen me pakice te produktit;

Produktet e duhanit per perdorim oral dhe produktet e duhanit pa diegie, do te mbajne te shkruara mbi to qarte ,lexueshem dhe ne gjuhen shqipe paralajmerimin: “Ky produkt duhani mund te demtoje shendetin tuaj dhe shkakton varesi”. Ky paralajmerim shtypet ne siperfaqen me te dukshme te paketes njesidhe ne nje paketim te jashtem, me perjashtim te mbeshtjellesve shtese transparente, te perdorura per shitjen me pakice te produktit.

Paralajmerimi i pergjithshem ne produktet e duhanit qe jane cigaret dhe ne produktet e duhanit per perdorim oral dhe pa djegie, duhet te zere 50 perqind te faqjes kryesore te shfaqur te pakos/paketes njesi te duhanit mbi te cilen shtypet.

Ne rastin e paketimeve njesi te perdorura per produktet e duhanit qe nuk jane cigaret si psh.,duhani per pertypje apo per nuhatje,dhe kur siperfaqja me e dukshme e se ciles tejkalon 75 perqind,paralajmerimet e pergjithshme do te mbulojne 37.5 perqind cm 2 te sejciles faqe

3) Nje paralajmerim shtese, me tekstin te marre nga lista e meposhteme e mesazheve:

- a)“ Duhanpiresit vdesin me te rinj”;
- b)“Duhanpirja bllokton arteriet dhe shkakton infark te zemres ose hemorragji cerebrale;
- c)“Duhanpirja shkakton kancer ne mushker”;
- d)“Duhanpirja gjate shtatezanise demton femijen tuaj;
- e)“Ruani femijet: mos i lini ata te thithin tymin tuaj;
- f)“Mjeku ose farmacisti juaj mund tju ndihmojne te lini duhanin”;
- g)“Duhanpirja shkakton varesi te forte,mos e filloni ate”;
- h)“Lenia e duhanit pakeson rrezikun e semundjeve vdekjepruresse te zemres dhe mushkerive”;
- i)“ Duhanpirja mund te shkaktoje nje vdekje te ngadalte dhe te dhimbshme”;
- j) “ Kerkoni ndihme per te lene duhanin: Telefon 0 800 47 47;Sektori i Abuzimit me substancat ,Instituti Shendetit Publik; [www.ishp@gov.al](mailto:www.ishp@gov.al)/konsultohuni me mjekun /farmacistin tuaj;
- k) “Duhanpirja mund te ngadalsoje rrjedhjen e gjakut dhe shkakton ipotence”;
- l) “Duhanpirja shkakton plakjen e fytyres”;
- m)“ Duhanpirja mund te demtoje spermen dhe ul pjellorine’;

n)“ Duhani permban benzen,nitrosamine,formaline dhe cianid hidrogjeni”;

Sejcili prej paralajmerimeve shendetesore shtese,si me siper ,do te rotullohet ne menyre te tille qe te sigurohet shfaqja e tyre e rregullt.

Paralajmerimi shtese do te jete i shtypur ne faqjen tjeter me te dukeshme pas faqjes kryesore te paketes njesi dhe ne nje paketim te jashtem,me perjashtim te mbeshtjellesve trasperente,te perdorura ne shitjen me pakice te produktit.

Teksti i paralajmerimeve shendetesore te pergjitheshme dhe shtese duhet te plotesoje keto:

- a) Te jete ne gjuhen shqipe;
- b) Te shtypen me shkrim te tipit “Helvetica bold”,ne nje sfonde te bardhe.Madhesia e ketij shkrimi,ne varesi te gjatesise se tekstit te paralajmerimit te zere pjesen me te madhe te mundeshme te sfondit te bardhe te parashikuar per tekstin e paralajmerimit;
- c) Te shtypen me shkronja te vogla,pervec shkronjes se pare te paralajmerimit si dhe kur kerkohet nga perdorimi gjuhesor;
- d) Te jene vendosur ne qender te sfondit te bardhe ne te cilen kerkohet qe te shtypet teksti dhe i vendosur paralelisht me brinjen e siperme te paketes;
- e) Sfondi i bardhe i parashikuar per tekstin e paralajmerimit te pergjithshem dhe paralajmerimit shtese do te jete i rrethuar nga nje brodure e zeze e cila do te jete jo me e ngushte se 3 mm dhe jo me e gjere se 4 mm.Kjo brodure nuk duhet te nderhyje, ne asnje menyre,tek teksti i paralajmerimit apo informacionin e dhene ne lidhje me produktin e duhanit;

Shtypja e teksteve te paralajmerimeve te detyruara shendetesore mbi pullat fiskale dhe pullat e cmimeve te paketave eshte e ndaluar.Tekstet e paralajmerimeve te detyrueshme shendetesore do te jene te shtypura ne menyre te palevizeshme,te pafshijshme dhe ne asnje menyre nuk duhet te jene te fshehura,te mbuluara ose te nderprera nga materiale te tjera te shkruara ose te pikturuara apo ne ne pjesen e hapjes se paketes se produktit te duhanit.Ne rastin e produkteve te duhanit te ndryshme nga cigaret,tekstet mund te ngjiten me ane te etiketave vetengjitese,me kusht qe keto etiketa vetengjitese te jene te palevizeshme.

Ky vendim u mor ne unanimitet te plote te te gjithe antareve te Komitetit Ndersektorial te Mbrojtjes se Shendetit nga produktet e Duhanit te pranishem ne kete mbledhje.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere dhe zbatimi i tij fillon me daten 1 Janar 2009.

Produktet e duhanit qe nuk jane shitur ne pikat e shitjes me pakice dhe qe nuk plotesojne keto norma, do lejohen te tregetohen ne pikat e shitjes te pakices deri ne daten 15.04 2009.(me qellim qe te shitet malli i ngelur stok).

Publikohet ne faqen e internetit te Ministrise se Shendetesise .

KNMSHPD do te kete te drejten te miratoje tekste te reja te paralajmerimeve shendetsore, 2 vjet pas hyrjes ne fuqi te ketij Vendimi.